



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 92

Tiranë – E enjte, 21 maj 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 20, datë 20.5.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar..... 5421
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 98, datë 28.4.2020	Autorizim i ndihmës shtetërore “COVID-19: skema mbështetëse në formën e grantit 2” 5421
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 80, datë 4.5.2020	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., nr. 291, seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 73, datë 13.5.2015..... 5423
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 81, datë 4.5.2020	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., nr. 290, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 72, datë 13.5.2015..... 5425
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 82, datë 4.5.2020	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Powercomm” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike..... 5426
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 83, datë 4.5.2020	Mbi shtyrjen e afatit të kryerjes së monitorimeve pranë shoqërive të licencuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centralet eolike..... 5427
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Kujtim Sema..... 5429



AKT NORMATIV
Nr. 20, datë 20.5.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË AKTIN NORMATIV NR.3,
DATË 15.3.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MARRJEN
E MASAVE TË VEÇANTA
ADMINISTRATIVE GJATË
KOHËZGJATJES SË PERIUdhËS
SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR
NGA COVID-19”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 3, të aktit normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“13. Të gjitha transmetimet audiovizive me më shumë se një person në të njëjtën studio televizive, që nuk respektojnë distancën e sigurisë prej 2 metrash nga njëri-tjetri, dënohen me gjobë në masën 1 000 000 (një milion) lekë dhe, në rast përsëritjeje, iu shtohet edhe vendosja e bllokimit, të pjesshëm ose të plotë, të transmetimit nga media audiovizive si dhe bllokimi dhe/ose ndalimi i funksionimit të pajisjeve, pas marrjes së vendimit nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe zbatohet nga organi kompetent.”.

2. Pas pikës 20 shtohet pika 21, me këtë përmbajtje:

“21. Moskryerja e aplikimit nga ana e subjektit të të punësuarit apo ish-të punësuarit që plotëson kushtet për të përfituar ndihmën financiare, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore të shpallur si pasoje e COVID-19, dënohet me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Subjektet, të cilat i kanë trajtuar me pagë të plotë të punësuarit apo ish-të punësuarit nuk gjobiten për mosaplikim për përfitimin e ndihmës financiare.

Subjektet e gjobituara mund të ushtrojnë të drejtën e ankimit pranë administratës tatimore,

duke paraqitur në rrugë elektronike, nëpërmjet portalit e-filing, shkaqet dhe/ose arsyet e mosaplikimit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e komunikimit të gjobës, sipas Kodit të Procedurave Administrative.”.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 98, datë 28.4.2020

AUTORIZIM I NDIHMËS
SHTETËRORE “COVID-19: SKEMA
MBËSHTETËSE NË FORMËN
E GRANTIT 2”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

Znj. Anila Denaj	kryetare;
Znj. Mimoza Dhëmbi	anëtare;
Znj. Etleva Haka	anëtare;
Znj. Mirjana Zisi	anëtare;
Z. Ahmet Mançellari	anëtar,

në mbledhjen e datës 28.4.2020, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’”, vlerësoi përputhjen me rregullat e ndihmës shtetërore të skemës së mbështetjes së ndërmarrjeve dhe individëve në kushtet e situatës së përhapjes së COVID-19.

Objekti i skemës së ndihmës: Skema synon t’u japë ndihmë në formën e granteve të drejtpërdrejta punonjësve të ndërmarrjeve, për të përballuar dëmin e shkaktuar nga përhapja e virusit COVID-19 dhe për ruajtjen e vazhdimësisë së veprimtarisë ekonomike gjatë dhe pas përhapjes së COVID-19, si dhe individëve.

Baza ligjore e skemës: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 305, datë 16.4.2020, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit



dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e COVID-19”.

Komisioni shqyrtoi këtë masë, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së skemës së sipërcituar me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe

VËREN SE:

1. Përfitues të ndihmës janë:

- të punësuarit në subjektet me të ardhura vjetore mbi 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, që kanë mbyllur aktivitetet, sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët kanë qenë në punë në datën e hyrjes në fuqi të këtyre urdhrave;

- të punësuarit në subjektet me të ardhura vjetore deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, që janë lejuar të kryejnë aktivitetet, sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët kanë qenë në punë deri në datën e hyrjes në fuqi të urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

- punonjësit e subjekteve, persona fizikë ose juridikë, që ushtrojnë aktivitetin si struktura akomoduese, të cilët figurojnë në listëpagesa deri në datën e urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2. Vlera e ndihmës shtetërore: Ndihma do të jepet në formën e grantit të miratuar në buxhetin e shtetit, për vitin 2020, me vlerë të përgjithshme 7 040 000 000 (shtatë miliardë e dyzet milionë) lekë.

3. Kohëzgjatja e ndihmës shtetërore: Skema do të hyjë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe do t'i shtrijë efektet gjatë gjendjes së epidemisë nga COVID-19, por jo më shumë se 3 (tre) muaj.

4. Administrimi i masës: Ministri i Shtetit për Rindërtim, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve janë përgjegjës për administrimin e masës.

5. Shtrirja sektoriale dhe rajonale e masës: Masa është e hapur për të gjithë sektorët, përveç institucioneve financiare dhe ndërmarrjeve publike. Masa jepet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

6. Elementet kryesorë të ndihmës:

1) ndihmë financiare prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh për të punësuarit në subjektet me të ardhura vjetore mbi 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë)

lekë, që kanë mbyllur aktivitetet, sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët kanë qenë në punë në datën e hyrjes në fuqi të këtyre urdhrave;

2) ndihmë financiare prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh për të punësuarit në subjektet me të ardhura vjetore deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, që janë lejuar të kryejnë aktivitetet, sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët kanë qenë në punë deri në datën e hyrjes në fuqi të urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

3) ndihmë financiare prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh për punonjësit e subjekteve, persona fizikë ose juridikë, që ushtrojnë aktivitetin si struktura akomoduese, të cilët figurojnë në listëpagesa deri në datën e urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

7. Ekzistenca e ndihmës shtetërore: Në kuptim të nenit 4, të ligjit për ndihmën shtetërore, skema përbën ndihmë shtetërore, duke qenë se:

- ndihma jepet nga buxheti i shtetit në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar;

- skema është selektive, sepse ndihma u jepet vetëm punonjësve të ndërmarrjeve të caktuara të regjistruar në QKB, me të ardhura vjetore deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, që janë lejuar të kryejnë aktivitetet, sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët kanë qenë në punë deri në datën e hyrjes në fuqi të urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, punonjësve të ndërmarrjeve me të ardhura vjetore mbi 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, që kanë mbyllur aktivitetet, sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët kanë qenë në punë në datën e hyrjes në fuqi të këtyre urdhrave, si edhe punonjësve të ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitetin në strukturat akomoduese;

- skema do të zbatohet në sektorë dhe ndërmarrje përfituese, të cilët janë aktivë në sektorët në të cilët ekziston tregtia ndërkombëtare.

Sa më lart, Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, vlerëson se skema mbështetëse me grant për punonjësit e ndërmarrjeve të sipërcituara, përfshihet në rastet e parashikuara ndryshe në këtë ligj dhe përbën ndihmë shtetërore, e cila është e lejueshme, në bazë



të shkronjës “b”, të nenit 13, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, e cila jepet për të mënjeluar gjendje të rënda në ekonominë e vendit të shkaktuar nga COVID-19.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të shkronjës “b”, të nenit 13, të shkronjës “a”, të nenit 17, të neneve 22, 30 dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë zbatimin e skemës së ndihmës shtetërore të parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 305, datë 16.4.2020, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna, si pasojë e COVID-19”, sepse ndihma jepet për të mënjeluar gjendjen e rëndë në ekonominë e vendit, si dhe për të shmangur efektet e shkaktuara nga fatkeqësia natyrore, e shkaktuar nga COVID-19.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të publikojë informacionin në lidhje me ndihmën e dhënë, në bazë të këtij vendimi, në faqen zyrtare, brenda 12 muajve nga momenti i dhënies dhe të raportojë pranë Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në zbatim të këtij vendimi.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, të raportojë pranë Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Anila Denaj**

**VENDIM
Nr. 80, datë 4.5.2020**

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “ALPIQ ENERGY
ALBANIA” SHPK, NR. 291, SERIA FK15,
NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, TË
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT
TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 73,
DATË 13.5.2015**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d”, nenit 13 dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.5.2020, mbasi shqyrtoi relacionet nr. 50/1, datë 23.4.2020 dhe 50/2 prot., datë 27.4.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Mbikëqyrjes dhe Autorizimeve, lidhur me “Rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Alpiq Energy Albania’ sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, si dhe informacionin shtesë nr. 50/1-1 prot., datë 30.4.2020,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 52, datë 26.3.2020, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, nëpërmjet postës elektronike zyrtare është kryer njoftimi në medien e shkruar, me komunikimin elektronik të datës 26.3.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të kishte vërejtje apo ankesa nga palë të treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k.



- Me komunikimin elektronik, të datës 30.3.2020, shoqërisë i është dërguar shkresa për njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesa për plotësimin e dokumentacionit të munguar, i cili konsistonte në:

- dokumentacionin e përgjithshëm: neni 16, pika 1, germa “b”;

- dokumentet juridike, administrative dhe pronësore: neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “d”, “e”;

- dokumentet financiare dhe fiskale: neni 9, pika 3, germa “c”;

- dokumentacionin teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike: neni 9, pika 4.7, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “g”, “h”, “i”.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., me komunikimin elektronik të datës 7.4.2020, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar, por duke qenë se u konstatuan sërish mungesa, ERE iu drejtua edhe një herë shoqërisë me komunikimin elektronik të datës 9.4.2020, të cilit shoqëria i është përgjigjur me *email*-in e datës 17.4.2020, duke plotësuar pjesërisht dokumentacionin e munguar.

- Me shkresën nr. 552/6, prot., të ERE-s, datë 30.4.2020, është përcjellë nga shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., vërtetimi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me anë të të cilit vërtetohet se nuk ka procedim penal në ngarkim të administratorëve të shoqërisë.

- Vlefshmëria e licencës së shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike përfundon në datën 13.5.2020, ndërsa aplikimi i shoqërisë për rinovim është kryer në datën 4.3.2020. Rezulton që shoqëria ka aplikuar brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në bazë të nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton si më poshtë:

- dokumentacioni i përgjithshëm: neni 16, pika 1, germa “b” – plotësuar;

- dokumentet juridike, administrative dhe pronësore: neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “e” – plotësuar;

- dokumentet financiare dhe fiskale: neni 9, pika 3, germa “c” – plotësuar.

- dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike: neni 9, pika 4.7, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “g”, “h”, “i” – plotësuar;

- pagesa e aplikimit dhe pagesa e rregullimit; neni 16, pika 7 – plotësuar;

- vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë: nenit 9, pika 2, germa “d” – plotësuar pjesërisht. Janë depozituar në ERE vërtetimet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për administratorët e shoqërisë.

- Në lidhje me kërkesën e nenit 9, pika 2, germa “d”, që lidhet me vërtetimin nga gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë, në bazë të pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”, shoqëria do të mund ta plotësojë brenda një muaji nga përfundimi i gjendjes së fatkeqësisë natyrore, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 291, seria F15, të shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.5.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar vlefshmërinë nga data 14.5.2020.

2. Shoqëria të plotësojë tërësisht kërkesat e nenit 9, pika 2, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, brenda një muaji nga përfundimi i gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”.



3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 81, datë 4.5.2020

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “ALPIQ ENERGY
ALBANIA” SHPK, NR. 290, SERIA T15,
NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, TË
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT
TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 72,
DATË 13.5.2015**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 13 dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.5.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Mbikëqyrjes dhe Autorizimeve lidhur me “Rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Alpiq Energy Albania’ sh.p.k., nr. 290, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 72, datë 13.5.2015”, si dhe informacionin shtesë nr. 50/1-1 prot., datë 30.4.2020,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 53, datë 26.3.2020, filloi procedurën për rinovimin e

licencës së e shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, nëpërmjet postës elektronike zyrtare është kryer njoftimi në medien e shkruar me komunikimin elektronik të datës 26.3.2020 dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palë të treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k.

- Nëpërmjet postës elektronike zyrtare, të datës 30.3.2020, shoqërisë i është dërguar shkresa për njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesa për plotësimin e dokumentacionit të munguar, i cili konsistonte në:

- dokumentacionin e përgjithshëm: neni 16, pika 1, germa “b”;

- dokumentet juridike, administrative dhe pronësore: neni 9, pika 2, gerrat “a”, “b”, “d”, “e”;

- dokumentet financiare dhe fiskale: neni 9, pika 3, germa “c”;

- dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike: neni 9, pika 4.8, gerrat “a”, “b”, “c”.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., me komunikimin elektronik të datës 7.4.2020, ka përcjellë në ERE pjesërisht dokumentacionin e munguar.

- Me shkresën nr. 552/6 prot., të ERE-s, datë 30.4.2020, është përcjellë nga shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., vërtetimi i prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me anë të të cilit vërtetohet se nuk ka procedim penal në ngarkim të administratorëve të shoqërisë.

- Rezulton që shoqëria ka aplikuar brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në bazë të nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezultoi si më poshtë:



- dokumentacioni i përgjithshëm: neni 16, pika 1, germa “a” – plotësuar;
- formati i aplikimit: neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c” – plotësuar;
- dokumentet juridike, administrative dhe pronësore: neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “e” – plotësuar;
- dokumentet financiare dhe fiskale: neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “c”, “d” – plotësuar;
- dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike: neni 9, pika 4.8, germat “a”, “b”, “c” – plotësuar;
- pagesa e aplikimit dhe pagesa e rregullimit: neni 16, pika 7 – plotësuar;
- vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë: neni 9, pika 2, germa “d” – plotësuar pjesërisht. Janë depozituar në ERE vërtetimet e prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për administratorët e shoqërisë.
- Në lidhje me kërkesën e neni 9, pika 2, germa “d”, që lidhet me vërtetimin nga gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë, në bazë të pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”, shoqëria do të mund ta plotësojë këtë kërkesë të rregullores brenda një muaji nga përfundimi i gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 290, seria T15, të shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, data 13.5.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 14.5.2020.

2. Shoqëria të plotësojë kërkesën e neni 9, pika 2, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, brenda një muaji nga

përfundimi i gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shpallur me vendimin e Këshillit të Ministrave.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 82, datë 4.5.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “POWERCOMM” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neni 4, pika 1, germa “e”, neni 5, pika 1, germa “e”, neni 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe neni 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.5.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Mbikëqyrjes dhe Autorizimeve, lidhur me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “PowerComm” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

- Shoqëria “PowerComm” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 662, datë 24.4.2020, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.



- Në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “PowerComm” sh.p.k., me aplikimin për pajisjen me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, rezulton si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim: neni 9, pika 1, germa “a”, “b”, “c” – plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor: neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “e” – plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal: neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “c”, “d” – plotësuar;

- dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike: neni 9, pika 4.8, pikat “a”, “b”, “c” – plotësuar.

- Për dokumentacionin e munguar, si kërkesë e nenit 9, pika 2, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” do të njoftohet aplikuesi për plotësimin e tij, brenda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “PowerComm” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 83, datë 4.5.2020

MBI SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË MONITORIMEVE PRANË SHOQËRIVE TË LICENCUARA NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALET EOLIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 68 dhe 93, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, me nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.5.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore, “Mbi zgjatjen e afatit të pezullimit të shqyrtimit të kërkesave të shoqërive të licencuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centralet eolike, në lidhje me shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të licencimit”,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 19, datë 31.1.2020, vendosi:

1. Shtyrjen deri në datën 29.2.2020, të afatit të pezullimit të parashikuar në pikën 3, të vendimeve:

a) nr. 173, datë 7.11.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘E-Vento S.R.L. Albania’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.7.2008, të ndryshuar”;

b) nr. 182, datë 20.11.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Albanian Green Energy’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 89, datë 6.8.2008, të ndryshuar”;

c) nr. 183, datë 20.11.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Bio Power Green Energy’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 90, datë 6.8.2008, të ndryshuar”;

2. Shtyrjen deri në datën 16.3.2020 të afatit të pezullimit të parashikuar në pikën 3 të vendimeve:

a) nr. 180, datë 20.11.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Hera’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar”;



b) nr. 181, datë 20.11.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘ALB Wind Energy’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 13, datë 28.1.2008, të ndryshuar”;

c) nr. 226, datë 20.12.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘ERS-08’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 63, datë 13.6.2008, të ndryshuar”.

Vendimmarrja sa më sipër u mor në kushtet, kur, për shkak të vështirësive që lidheshin me shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 755, datë 27.11.2019, terrenit të vështirë në të cilin janë planifikuar për t’u ndërtuar projektet eolike, mbledhjes së të dhënave të nevojshme, monitorimi i ushtruar nga ERE rezultoi i vështirë për t’u përfunduar brenda afateve të parashikuara.

- Në vijim të vendimmarrjes së ERE-s nr. 19, datë 31.1.2020, grupet e punës të ngritura nga ERE, me qëllim ushtrimin e një monitorimi të thelluar në analizë të shkaqeve që kanë pamundësuar përmbushjen në afat nga të licencuarit të kushteve të vendimeve respektive të ERE-s, kanë vijuar punën për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave të domosdoshme.

- Rezulton se janë kryer monitorimet në terren për të gjithë të licencuarit subjekte të monitorimit, në zbatim të pikës 2, të vendimeve të ERE-s nr. 173, datë 7.11.2019; nr. 182, datë 20.11.2019; nr. 183, datë 20.11.2019; nr. 180, datë 20.11.2019; nr. 181, datë 20.11.2019; nr. 226, datë 20.12.2019.

- Rezulton se janë mbledhur dhe përpunuar një pjesë e të dhënave administrative dhe financiare të shoqërive të licencuara.

- Në kuptim të vendimeve të Bordit të ERE-s nr. 173, datë 7.11.2019; nr. 182, datë 20.11.2019; nr. 183, datë 20.11.2019; nr. 180, datë 20.11.2019; nr. 181, datë 20.11.2019; nr. 226, datë 20.12.2019, rezulton se me qëllim arritjen në konkluzione përfundimtare në lidhje me kërkesën e të licencuarve për shtyrjen e afateve të plotësimit të kushteve, është e nevojshme të vijohet e thellohet monitorimi, duke mbledhur të dhëna e dokumentacion financiar e administrativ, jo vetëm nga të licencuarit, por edhe nga palë të treta, me të cilët të licencuarit kanë nënkontraktuar, me qëllim përmbushjen e kushteve të vendimeve të ERE-s për licencimin e tyre.

- Në dijeni të ERE-s, nuk rezulton që pranë institucionit përgjegjës, Autoritetit Shtetëror Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të jetë

regjistruar shfaqje interesi për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga impiantet eolike në zonat në të cilat janë licencuar të ushtrojnë aktivitetin të licencuarit e sipërcituar.

- Në datën 23.4.2020, Kuvendi i Shqipërisë votoi për shtyrjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Republikën e Shqipërisë deri në datën 23.6.2020, duke zgatur edhe afatin e efekteve shtrënguese të marra nga qeveria shqiptare përgjatë kësaj periudhe, me qëllim mbrojtjen e popullsisë nga përhapja e epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19.

- Neni 91, pika 4, i Kodit të Procedurave Administrative parashikon mbylljen e procedurave administrative, brenda 3 muajve nga dita e përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme, e cila në kuptim të kufizimeve kushtetuese të vendosura nga qeveria shqiptare, e pamundësojnë mbylljen e procedurës së monitorimit përpara këtij afati.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen me 2 (dy) muaj pas përfundimit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të afatit të pezullimit të parashikuar në pikën 3, të vendimeve në vijim:

a) nr. 173, datë 7.11.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘E-Vento S.R.L. Albania’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.7.2008, të ndryshuar”;

b) nr. 182, datë 20.11.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Albanian Green Energy’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 89, datë 6.8.2008, të ndryshuar”;

c) nr. 183, datë 20.11.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Bio power Green Energy’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 90, datë 6.8.2008, të ndryshuar”;

d) nr. 180, datë 20.11.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Hera’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar”;

e) nr. 181, datë 20.11.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Alb Wind Energy’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 13, datë 28.1.2008, të ndryshuar”;

f) nr. 226, datë 20.12.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘ERS-08’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 63, datë 13.6.2008, të ndryshuar”.



2. Kjo vendimarrje është objekt rishikimi nga ERE në çdo kohë, në rast se ndryshojnë rrethanat e konstatuara në të.

3. Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. 62-2020-863(265), datë 24.2.2020 vendosi shpalljen e zhdukjes së shtetasit Kujtim Sema, i datëlindjes 7.6.1971, si dhe caktimin e datës 30.12.1999 si datën e vdekjes së tij. Për administrimin e pasurisë së tij caktohet si kujdestar babi i tij, shtetasi Marko Sema.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë